



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

01Nr 06-42503 /23

Klinë, dt 20/12 /23

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur, më 28.04.2023, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 16:00.

Mbledhjen e udhëhoqi Nënkyetarja e komunës së Klinës, Marqe Tanushi-Selmanaj, e cila përshëndeti të gjithë anëtarët e KKSB-së dhe prezantoi rendin e ditës:

1. *Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;*
2. *Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në Komunën e Klinës;*
3. *Nxitja e vetëdijesimit nga rreziku i përdorimit të narkotikëve dhe dukurive tjera negative;*
4. *Të ndryshme.*

Pika 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Theksoi dhe kërkoi falje sepse procesverbali nuk është shpërndarë me kohë për arsyen teknike dhe për këtë nuk ka qenë e mundur të përkthehet në gjuhën serbe, kërkoi edhe në emër të koordinatores dhe shpresoi që në mbledhjet e radhës të jetë përgatitur në gjuhë.

Zv. Kryesuesja pyeti nëse dikush ka për të shtuar në lidhje me procesverbalin dhe nëse janë pror miratimit të tij edhe pse ishte një kohë e shkurtër që ta lexojnë,

anëtarët votuan pro që të gjithë dhe i kalojë fjalën komandantit të Policisë për të kaluar tek pika e dytë e rendit të ditës.

Pika 2. Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në Komunën e Klinës.

Komandanti, z.Ragip Bytyqi: Përshëndeti të gjithë dhe theksoi që në grupin që kemi formuar në Viber ka pritur që të jenë më aktivë, që për çdo gjë që ju intereson në lidhje me sigurinë në Komunën e Klinës, të mos hezitojnë që të shkruajnë dhe të mos mbetet gruپi vetëm që koordinatorja të njoftojë për mbledhjet në vazhdimësi se kur mbahen.

Komandanti potencoi që gjendja në Komunën tonë është relativisht e qetë në këtë tremujorin e parë, ku është karakterizuar me disa raste sporadike të veprave të ndryshme penale.

Disa incidente më të theksuara në zonën tonë janë: 13 raste të dhunës në familje, ku ditët e fundit i kemi pasur disa raste më të ndjeshme, 4 raste i kemi të falsifikimit të parasë, 8 raste vjedhje të rënda, 9 raste janë vjedhje të imta, janë 4 dëmtime të pasurisë së luajtshme, e kemi një rast të mashtrimit, 10 raste janë për armëmbajtje ku 2 prej tyre janë përdorim i armës, janë raportuar 133 incidente të natyrave të ndryshme, ku 99 prej incidenteve kanë të bëjnë me vepra penale, ku 84.1% prej tyre janë zbuluar këtu në stacionin tonë. Për 10 vitet e fundit kemi thyer rekord për zbulueshmërinë, është shifër goxha e vështirë e realizueshme, por, falë angazhimit të të gjithë zyrtarëve policorë, duke mos e përjashtuar edhe ndihmën e qytetarëve kemi arritur rekord këtë vit, po ne nuk do të jemi të kënaqur vetëm me këtë rekord, po shpresoj që në pjesën e dytë të vitit të kemi suksesë edhe më shumë. Kanë ndodhur 36 aksidente me dëme materiale, janë shqiptuar 2049 gjoba të ndryshme për kundërvajtje dhe janë 3 raste të posedimit të narkotikëve, dmth është një sasi e vogël, jo sasi e madhe. Këto janë statistika në pika të shkurta për tremujorin e parë të këtij viti.

Jemi karakterizuar me shumë angazhime të tjera, qoftë asistime me institucione tjera jashtë policore, duke përfshirë me inspektorat KED-si, inspektorë të ATK-së dhe organizata tjera që kërkojnë ndihmë në çdo kohë nga Policia, dmth kemi pasur angazhime edhe në pjesë tjera të Kosovës ku kemi dhanë asistime në zyrtarë në baza ditore, javore dhe mujore. Lirisht, deri më tanë mund të them se situatën e kemi shumë të qetë edhe në rregull. Faleminderit, nëse ka ndokush diçka, unë jam këtu të përgjigjem.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë komandant, unë tash po e shfrytëzoj rastin dhe po përgjigjem në pyetjet që janë bërë në mbledhjen e kaluar; e para ishte për Ragip Kryeziun e propozuar nga Josip Dedaj, besoj që ne jemi mirënjoës gjithmonë për punën dhe kontributin. Ragip dhe kryetari patjetër që e ka aprovuar që të ndahet një mirënjoje në një situatë e kon me punën që e bën, pyetja tjetër ishte situata me mësuesen Verë, prapë nga Josip e kisha lutar drejtorin e Arsimit që të na tregojë se deri ku është gjendja, dhe me siguri i ka informacionet e sakta dhe na tregon.

Z.Qemajl Sejdija, drejtor i DKA-së: Faleminderit nënkyretare, përshëndetje për të gjithë! Së pari kërkoj falje për mbledhjen e kaluar që nuk kam qenë prezent kur Josipi është drejtar me këtë pyetje.

Ne e kemi pasur një ankesë nga prindi për ushtrim dhune ndaj fëmijës së tij që e kemi pranuar në DKA, nga ajo ditë ne i kemi marrë të gjitha masat, e kemi shikuar të kaluarën për mësuesen në fjalë dhe nuk kemi gjetur asnje ankesë, pastaj e kemi pasur edhe një takim me prindin, ku prindi ka thënë që më shumë ka pasur tendencë për ta ndërruar klasën dhe që drejtoria e shkollës nuk e ka marrë parasysh kërkesën e vazhdueshme të prindit. Ne kemi ardhur në përfundim dhe nuk kemi gjetur diçka shkelje, për këtë rast janë të njoftuara edhe organet dhe në fund si Drejtori e Arsimit kemi rekomanduar që nxënësit në fjalë t'i ndërrohet klasa. Në momentin që e kemi dërguar ne si drejtori rekomandimin, atëherë prindi ka ardhur dhe ka thënë që ne dëshirojmë ta lëmë në atë klasë aty ku është dhe prindi është pajtuar dhe e ka nënshkruar një letër pajtim për atë pjesë dhe nxënësi vazhdon aty, dhe situata është kjo që e shpjegova, ju faleminderit shumë.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, drejtor! Gjendja me nxënësin shumë në rregull, por, gjendja për mësuesen në çka ka kaluar është pak më ndryshe. Por, këto janë situata që nuk varen nga ne dhe ju si drejtori, kjo le të jetë në ndërgjegjen e çdo prindi dhe nxënësi mundohet që në një situatë të tillë të nxjerrë konkluzione të ndryshme dhe të ulë reputacionin, qoftë të mësuesit, qoftë qytetarit, kushdo qoftë, këto janë gjëra të shëmtuara. Nëse nuk ka pasur fakte ose nëse nuk ka pasur thjeshtë në atë që ka akuzuar, ndjej keqardhje edhe njëherë për mësuesen Verë, situata qenka kështu dhe po besoj që gjithçka është në rregull.

Anëtar i KKSB-së: Unë kisha thënë që mos të lihet kjo punë me keqardhje, por të merren masa ndaj prindit.

Z.Qemajl Sejdija, drejtor i DKA-së: Faleminderit i nderuar, ne e dimë shumë mirë që stafin mësimor e përzgjedhim ne, ndërsa prindërit dhe fëmijët janë të Komunës sonë dhe ne duhet me mbajtë çdo shqetësim, duhet me marrë për bazë çdo gjë. Ne kemi marrë raport i kemi dëgjuar të dyja palët dhe nuk është që nuk përdoret dhunë të jemi të qartë, por, është mirë që çdo dhunë ku ka të raportohet. Për rastin në fjalë unë e dhashë shpjegimin, për shkak se mësuesja nuk ka pasur faj ne nuk kemi marrë masa, në të kundërtën nëse kishim pasur dëshmi dhe fakte ne kishim marrë masa, nuk kemi vërejtur ndonjë shkelje nga mësimdhënësja, por kemi dhënë masa për nxënësin ku i kemi ndërruar klasën, sepse atë kërkesë e ka pasur të vazhdueshme dhe unë si drejtor duhet t'i marrë shqetësimet nga prindërit dhe nxënësit, sepse për personel ne e dimë që jemi përgjegjës dhe jemi gjithmonë në shërbim të tyre.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit, drejtor! Pyetja tjetër ishte nga hoxha në lidhje për barnatoren kujdestare, -
- Jini diskutuar këtë temë në bord të drejtorëve, e kam ngre si çështje dhe fakt është që pas orës 23:00 nuk ka barnatore që kujdestaron, e vetmja mundësi është që shërbimet të jepen përmes QKMF-së, ku kryesisht ka disa nga

barnat esenciale, por që nuk është që e plotëson atë që është kërkuar nga qytetari. Jo që nuk është kërkesë e QKMF-së e stafit, po barnatoret kujdestarinë duhet ta kenë nga stafi profesional dhe punëtorë profesional nuk ka që të mbulohen gjatë natës.

Faleminderit edhe njëherë për pyetjet që i bëni, që shkojnë në dobi për qytetarët e Klinës.

Pika 3. Ngritja e vetëdijesimit nga rreziku i përdorimit të narkotikëve dhe dukurive tjera negative.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: E kemi përzgjedhur si temë e cila ka qenë në planin e KKSB-së, është një temë që i përfshinë të gjitha grupet pa dallim. Unë edhe pse materialin e kisha të përgatitur, unë nuk jam kompetente të flas për dukuri të tilla, mua më intereson fakti se ku jemi me gjendje sa i përket kësaj teme, cilat janë shqetësimet tona dhe të rinxve të qytetarëve të Komunës tonë. Ne gjithmonë kemi komandantin e Policisë që i përket sigurisë, mandej kemi drejtorin e Arsimit që i përket grupit të moshave të ndryshme, ku besoj që do të mundemi bashkë të shohim se ku jemi me gjendjen.

Komandanti, z.Ragip Bytyqi: Siç jeni të informuar, çdo vit kalendarik Policia nëpër shkolla e ka planin operativ për ngritjen e nivelit tek nxënësit për përdorimin e substancave të ndryshme narkotike. Vitin e kaluar në shkollat fillore dhe të mesme i kemi pasur të angazhuar 2-3 zyrtarë që kanë qenë në patrullim pothuajse në të gjitha zonat tona, ku fillimisht informacionet tona kanë qenë shumë shumë shqetësuese, por pas implementimit të atij plani operativ, situata në terren ka ndryshuar. Fatmirësish situata nuk ka dal ashtu siç kemi pritur, atë plan operativ jemi duke e implementuar akoma edhe këtë vit, edhe pse nuk jemi të kënaqur, ne, në baza ditore pranojmë informacione ku secilin informacion të këtyre dukurive negative e trajtojmë me përkushtim të veçantë. Shqetësuese ka qenë shkolla në Gllarevë ku i kemi marrë disa vepime, dhe besoj që shumë shpejtë do të korrim suksese ndaj kësaj fushe negative. Unë pres sa i përket kësaj pike të kemi bashkëpunim nga secili qytetar, sepse nuk kemi mundësi pa këto bashkëpunime të ja dalim vetëm.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Ne, në plan kemi paraparë që në shkollat fillore dhe shkollat e mesme të ulëta, të ketë edhe trajnime vetëdijesuese për këtë temë, të kenë informata se cilat janë drogat, rreziqet dhe dëmet që vijnë prej tyre, dhe besoj që Drejtoria e Arsimit ka në plan diçka!

Z.Qemajl Sejdija, drejtor i DKA-së: Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, çdo vit nuk ju mungojnë ligjératat rreth dukurive negative dhe kemi një bashkëpunim shumë të mirë me Polici i Komunës së Klinës dhe kemi ligjérata të vazhdueshme rreth dukurive negative i edhe organizata joqeveritare që shkojnë përmes MASHT-it dhe marrin pjesë i këtij ligjérata të vazhdueshme. Çka vjen më shumë është kujdesi prindëror që duhet të jetë ndaj fëmijëve, ne kemi pasur takim edhe me kryetarin e Këshillit të Prindërve që e kemi këtu prezent, prindërit duhet të kenë më

shumë kujdes sepse ne i dimë grupmoshat që shkojnë në shkollë, që janë në atë moshë që nuk kanë njohuri lidhur me këto dukuri. Ju kisha lutar prindërve që të jenë sa më të kujdeshshëm sepse sa i përket ligjëratave dhe njoftimeve i kemi çdo vit bashkë me policinë.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Kuptohet që familja është filesa e çdo gjëje që është pozitive, dhe këtu bashkërisht kemi fatin që të jemi bashkë të gjitha strukturat institucionale. Për këtë arsy është edhe KKSBB-ja, sepse këtu është niveli lokal ku është Arsimi, mandej është Policia, janë përfaqësuesit e klerit, mandej institucionet, që të gjitha bashkërisht kanë mundësinë të bëjnë punët më të mirat përfshirë.

Pika 4. Të ndryshme.

Z. Hazir Tigani: Përgëzoj Policinë dhe Drejtoren e Arsimit për ligjëratat që mbajnë për vetëdijesimin ndaj këtyre dukurive negative, ku theksoj që ka qenë prezent në një prej ligjëratave dhe tregoj për interesimin e nxënësve në raport me këto ligjërata, dhe bëri apel që të vazhdohet në të gjitha shkollat me ligjërata sepse janë frytdhënëse dhe shumë të dobishme.

Z.Josip Dedaj: Potencoj tek rasti i mësueses Verë, që është marrë edhe me familjen edhe me policinë dhe me imamin e xhamisë, por përgjigja juaj si po del ka mbërrij ta largoje nxënësin. Por, a e dini që familjari i ka prurë 4 media në shkollën fillore “Motrat Qiriazi” ku ajo nuk ka përdorur dhunë siç kanë shkruar në facebook, por e ka parë si fëmijën e vet, ndoshta këtë e di, por nuk e flet, e dyta; ju si drejtori është dashtë me inicuar në prokurori rastin ku ose ka faj mësuesja ose ka faj prindi, të dy në këtë mes nuk dalin të pastër, njëri duhet të shkojë në burg ose të merret masa ndaj tyre.

Pastaj, nënkyetare, rruga për në Dresnik, ke thënë që deri më 15 mars fillon rruga, po aty as që ka ardhur dikush ta shikojë atë rrugë, jemi 26 shtëpi dhe rruga e Dresnikut nuk ka asfalt. Pika e tretë është shenjat e komunikacionit në rrugë, ku para vitit të ri është hapur tenderi, kanë nisur diku-diku të punojnë, por unë s'jam duke parë diku në Komunë që janë vendosur shenjat, trotuaret janë në gjendje shumë të keqe, jemi qendër dhe po besoj që ishte dashtë ndoshta aq buxhet të ketë sa për t'i irregulluar këto. Për qentë endacakë nuk po e them sepse e di që Komuna më duket nuk e ka tenderin për këta, por, me të vërtetë jemi në zor prej tyre sepse transport për në fshat nuk kemi dhe herëdo-kurdo mundemi me qenë në rrezik prej tyre, faleminderit.

Z.Qemajl Sejdija: Po besoj që ne të gjithë i kemi përgjegjësitë tona të ndara. Ai rast është i lajmëruar në polici, në media, gjë cë Vajtjet e Kosovës na garanton se cilin individ si ne e shohim me bërë ankesë ose çka tjetër atë ajo. Sa i përket Drejtorisë së Arsimit e kemi kryer punën tonë edhe Policia e ka kryer punën e vet, nëse individët dëshirojnë m'u marrë me atë punë, kanë të drejtë, ne nuk japim as vendim, as gjykim, vetëm gjykata vjen në përfundim për rastin dhe ata vendosin, për pjesën tonë të tregova që gjithçka e kemi

përfunduar, saleminderit!

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, drejtor! Po, Josip, e pranojmë që gjendja në atë rrugë është ashtu siç thua ti, unë vazhdimisht e ngre si çështje në bord, e kam edhe dëshmitar drejtorin, por ju e dini se roli i nënkyretares ka detyra të deleguara dhe si zv. Kryesuese e KKSB-së mundohem që këto probleme t'i përcjelli ku është vendi dhe më shumë përkushtim çdo kërkesë mundohem ta adresojë. Mirëpo, sa mund t'i realizojmë të gjitha, e kam thënë edhe herëve tjera që jo të gjitha janë të realizueshme, përgjigja për rrugën e juaj është vazhdimisht që është problem i nivelit qendror dhe nëse këtë vit ministria nuk fillon punën, atëherë komuna do t'i merr punët në dorë dhe do të përfundojë rruga, kështu më është thënë. Vendosja e shenjave të komunikacionit, faktikisht ato janë vendosur, kanë filluar me u vendosë po edhe kjo si çështje është ngritur sepse është parë se ende nuk është në nivelin e duhur. Për rrugë, ke kritikë me vend, Josip!

Z.Jeton Sokoli: Përshëndetje për të gjithë dhe kërkoj falje për vonesën. Duke u nisur nga një emision në Shqipëri dhe m'u kujtua rasti që disa vajza i kam parë edhe në qytetin e Klinës, në Gjakovë dhe qytete të tjera, që mbledhin para në rrugë për raste me persona të sëmurë, me emër dhe mbiemër që kanë nevojë për të holla, dhe desha të di që, policia a është në dijeni për këtë grup, a është organizatë, a e dinë se kush është pas tyre apo thjeshtë janë njerëz që po përfitojnë në emër të familjeve të varfra?

Komandanti z.Ragip Bytyqi: Siç e keni parë në rrjete sociale, një rast para 2-3 muajve i kemi përcjell nga Shqipëria, ne e kemi në arrest personin e dyshimit, e kemi shoqëruar në stacion dhe me rekomandim të prokurorit ne e kemi inicuar procedurën. Rastet e tjera, ne, në vazhdimësi i mbikëqyrim dhe në ato raste ku elemente të veprës penale ne e iniciojmë procedurën edhe normalisht që i dërgojmë në prokurori. Është një rrjet i organizuar mirë dhe ato rrjete kanë filluar të shkatërrohen pjesë-pjesë, po ne këtu në Klinë janë 3-4 raste që i kemi inicuar dhe ka ditë që këtu në Klinë nuk kam parë raste duke kërkuar të holla, por në rast që ju shihni raste duke kërkuar të holla që kanë edhe dokumente me vete, atëherë kërkoj nga ju që të na lajmëroni menjëherë që ne të intervenojmë dhe t'i verifikojmë rastet.

Znj. Silvia Rashkoviq: Zyra jonë bashkëpunon me ju policinë dhe kur zyra jonë raporton diçka dhe kërkojmë që të dalim bashkë me juve në terren, ka qenë një rast i vjedhjes, a duhet të dalim së bashku me policinë me këqyr vendin e ngjarjes edhe nëse pronari i shtëpisë nuk është aty, a ka obligim policia të dalë në vend të ngjarjes?

Komandanti z.Ragip Bytyqi: Normalisht që policia kur merr informacion për ndonjë veprë që është veprë penale, normalisht duhet me dalë në vend të ngjarjes dhe me konstatuar që a ka elemente të veprës penale, pa marrë parasysh a është pronari apo nuk është, ndërkaq nuk është e thënë me qenë patjetër me juve, ju mjafton të na informoni neve dhe ne ta kryejmë punën tonë.

Harrova të ju tregoj që është hapur konkursi për minoritete, shfrytëzoj rastin meqenëse jeni përfaqësues të Bashkësive Lokale, kërkoj të informohen grupet e minoritetave që të konkurrojnë kush ka dëshirë dhe të drejtë, është i hapur edhe për 10 ditët e ardhshme.

Znj.Silvia Rashkoviq: Jemi duke pritur ta bëjmë një takim me përfaqësuesit e fshatrave ku ka minoritete dhe normalisht t'i njoftojmë për procedurat e konkursit, faleminderit.

Z.Jeton Sokoli: Ju njoftoj që në muajin maj, me datat 16-17 do të kemi vizita falas në QKMF “Nënë Tereza” ku do të vijnë mjekë të përgjithshëm Amerikan, ku do të bëjnë kontolle falas dhe ilaçet që do t'i marrin, do t'i shpërndajnë falas.

Z.Jeton Thaçi: Përshëndetje për të gjithë, unë shpresoj që mos të keqkuptohem, por, dëshiroj ta paraqes një shqetësim të shumë besimtarëve dhe shumë qytetarëve të Klinës, për sa i përket ndarjes së dhuratave dhe festimit të Bajramit në sheshin e Komunës, nëse mund të them në ambientet e Komunës. Jo që ka diçka të keqe aty, por unë mendoj që ne jetojmë në një vend demokratik, në një shtet laik ku institucionet komunale shtetërore duhet të janë të barabarta ndaj të gjitha komunitetave dhe besoj që duhet ta ruajmë laicitetin e shtetit dhe ndoshta më shumë se shqetësim i imi, jo i kishës, do duhej të ishte shqetësim i institucioneve Komunale, për shkak se nëse vazhdojmë kështu, atëherë kisha katolike shpërndanë dhurata për fëmijë dy herë në vit dhe shpërndanë ndihma vazhdimisht çdo muaj dhe në mënyrë të veçantë para Krishtlindjeve dhe Pashkëve, dhe atëherë nëse vazhdohet në këtë mënyrë, po e bëjmë edhe ne në shesh edhe shpërndarjen e dhuratave. Më vjen keq që nuk është hoxha këtu dhe nuk është kjo me ngrit tensione, por është më mirë me i thënë gjërat që i kemi dhe që i mendojmë. Më mirë do të ishte se, nëse nuk ka hapësirë hoxha, që t'ia lëshojmë oborrin e Kishës dhe bashkë t'i shpërndajmë, se sa ndoshta institucionet Komunale të përfshihen në këtë gjë. Mendoj më mirë është në ambientin tonë ku jetojmë të ruhet laiciteti i shtetit dhe i Komunës, po kërkoj edhe njëherë që të mos keqkuptohet ky intervenim i imi, por të jetë me të vërtetë në dobi të të gjithë qytetarëve që të mos e shqetësojnë njëri-tjetrin kot dhe pa nevojë, faleminderit.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit zotni, të përgëzoj për paraqitjen tënde! Në momentin që gjërat thuhen hapur, aty nuk lë vend për mendime negative dhe gjëra tjera ndryshe.

Unë faktikisht nuk isha në dijeni se çka po ndodh aty, me sa mora informata nga vetë kryetari, leja ose në njëfarë forme ka qenë vetëm që aty të ndahen ndihma për njerëzit, por jo të shfrytëzohet Komuna si objekt festë, sepse jo vetëm kryetari që e di dhe është shumë i kujdeshshëm për të gjitha zonat pa dallim, por të gjithë e dimë që Komuna është institucion i pavarur prej fesë dhe Komuna e Klinës është një ndër Komunat që ka një kulturë të tolerancës dhe bashkëveprimit, bashkëjetesës me të gjitha besimet që jetojmë, gjithë bashkë, ashtu siç jemi sot, gjithë rritur këtu në KKSB. Kjo e bën Komunën e Klinës shumë kulturore, dimensionale, na bën të gjithëve me u ndje mirë, tash unë nuk mundem me paraqit hipokritin në këtë rast, me thënë se nuk e di çka ka ndodhur sepse unë nuk jam person i tillë, të gjithëve na ka vrarë syrin mënyra sepse Komuna e ka ruajtur

gjithmonë laicitetin dhe është dëshmuar që jo vetëm Komuna, po edhe kryetarët në vazhdimësi, por edhe kryetari që është aktual i cili pa dallim me të gjitha mundësitë e tij, s'ka ndarë asnje zonë dhe ka bashkëvepruar me të gjithë, mirëpo, sa unë e kam kuptuar edhe pse s'kam hyrë ende në detaje sepse kisha një trajnim treditor dhe isha jashtë procesit, ndoshta edhe kryetarit i është punuar në njëfarë forme tërthore. Nuk e di për mos me dhanë shumë komplikime, nuk e di nga çfarë personash që sigurisht e kanë pasur mendimin e mirë që të ndajnë dhurata për njerëzit që kanë nevojë, por, që në njëfarë forme ndoshta është keqkuptuar ose Komuna ju ka dhanë një imazh fetar, gjë çka unë nuk e besoj një të tillë sepse neve asnje nuk na pengon, sepse ne mbi të gjitha duke qenë te një etniciteti, një grup dhe besimeve tjera nuk është që na ka shprehur ndonjë indinjatë mua personalisht ndoshta vetëm ai imazhi se i dha Komunës, ndoshta pak na bën me u ndjerë jo fort komod.

Mirëpo, për ta qetësuar gjendjen, faleminderit shumë që e hape si temë, mua më pëlqejnë gjërat kur diskutohen dhe nuk ndrydhen, se plasin diku tjetër dhe të përgëzoj përgjimini dhe përmundësinë që na dhe për me treguar se kryetari nuk ka dhanë leje të shkruhen mbishkrime, të zbukurohen. Kryetari, jam shumë e bindur që e ka dhanë lejen që ato ndihma t'ju shpërndahen qytetarëve në një festë të cilën e kemi uruar të gjithë, ku kemi pasur fatin t'i kemi tri festa radhazi: Pashkët Katolike, ato Ortodokse si dhe Bajramin, ku jemi këtu gjithë bashkë dhe i urojmë dhe festojmë gjithë bashkë dhe kisha dashtë pasi ti je pjesë që i prinë një etniteti, ta keni atë mesazhin që e përçon personalisht ti dhe kleri tjetër, që kjo të jetë e izoluar dhe të mos merr përmasa tjera, sepse me të vërtetë nuk e kemi as Komunën e tillë, nuk e kemi as kryetarin e tillë, as iniciativat e tilla. E thamë pjesën më të madhe ne jemi të gjithë bashkë, nuk dua të ndalem tani që jemi gjithë dhe gjithë duhet të jemi gjithmonë dhe nuk besoj që ka qenë mesazhi i kryetarit, as i nënkyretares, as i stafit, por ka qenë diçka që nuk e kanë analizuar ata që e kanë bërë.

Z.Jeton Thaci: Unë kisha pasur dëshirë me ditë kush e ka bërë kërkesën, a ka kërkesë me shkrim dhe kush e ka pranuar atë kërkesë dhe a ka përgjigje me shkrim nga ana e institucioneve dhe nëse ju thoni që ato janë vënë pa leje të kryetarit, dmth aty kemi abuzim, sepse unë nuk mundem me vënë në qytet një pllakat pa lejen e institucionit. Mendoj se është një lloj abuzimi, më falni nëse më lejohet, por unë e dua një shtet që i respekton ligjet e ju Komuna duhet me qenë shembull model për të gjithë qytetarët në respektimin e ligjit, sikurse edhe ne prijësit fetarë.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, zotni! Unë e thash, ndoshta përgjigjen më të saktë do ta jap në mbledhjen e radhës, sepse nuk është që kam shumë informata, por ajo që unë sot mora shkitazi, leja është dhanë për t'u shpërndarë ndihma, kaq m'u dha si informatë. Nuk mendova që do të kem nevojë unë me dhanë këtë sqarim, mirëpo pasi m'u dha mundësia po mur kështu për ta sqaruar, leja është dhanë për t'u shpërndarë ndihmat dhe mënyra tjetë procedurale se si ka shkuar unë nuk jam e informuar, nuk dua të mbuloj as të shkak ndonjë informatë jo të qëndrueshme, sepse nuk duhet me dhanë informatë çka nuk qëndron në asnijëren anë, në asnijëren palë, mirëpo krejt çka unë mendoj dhe dua ta mendoj shumë është që ka qenë një akt bamirësie që

mandej ka kaluar në diçka që ndoshta i ka dhanë komunës sonë. Jam shumë e sigurt që ti zotni, don Jeton, me të gjithë tjerët prirës të Komunës, keni për ta ditur bashkë, sikur keni ditur gjithmonë me qenë unifikues, dhe në njëfarë forme unë në emër të të gjithëve nuk di a më lejohet, por, unë zakonisht e kam guximin të kërkojë falje nëse kemi gabuar diçka, ka qenë pa dashje, kërkoj falje publike unë personalisht, faleminderit shumë!

Zv.Kryesuesja mbylli takimin duke ju uruar çdo të mirë dhe duke ju thënë që do të shihen në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësja,
Orgeta Sylaj



Zv. Kryesuesja
Marqe Selmanaj

